

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Miliarderi Leon Black sfidon Kongresin e SHBA-së, refuzon dëshminë për lidhjet financiare me Jeffrey E pstein-in
ADRESA	https://indeksonline.net/miliarderi-leon-black-sfidon-kongresin-e-shba-se-refuzon-deshmi-ne-per-lidhjet-financiare-me-jeffrey-epstein-in/
BURIMI	indeksonline.net
GJENDJA	edited

KOHA


KAPUR NGA NE	6 shtator 2026, 18:14:01 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	4 shtator 2026, 07:49:28 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	f21484c177fb099d233ec576f60cc13c3610b8fad3f22523ff070cc6fb6f93ae
TEKSTI	61eaedb9e5ce8a419439246536e0e332ab0b0394067f2a53660d7e3d96c49c7f
PAMJA	b94dfcbf1caceea4a0c1b6d5e0cb871269fdd9c9d737bf6d122aa2591b672444

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	ee845aefb5dc7d19f2f428d82de73764fb800716b12e6059476f944dc6154aec
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	00a00f473eee6089e629c3fbe5b781cecb40006581d22ebdfab6238166e5deac
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/ee845aefb5dc7d19f2f428d82de73764fb800716b12e6059476f944dc6154aec>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored · dritarja 1280×1024 px

- [Ballina](#)
- [Lajme](#)
- [Sport](#)
- [Showbiz](#)
- [Tech](#)
- [Auto](#)
- [Kuriozitete](#)
- [Indeks+](#)
- [Ekonomi](#)
- [Shëndetësi](#)
- [Zgjedhjet](#)
- [Opinion](#)





SHPËRNDAJE








09:49 / E Premte, 04 Shtator 2026 / Z S

Miliarderi Leon Black sfidon Kongresin e SHBA-së, refuzon dëshminë për lidhjet financiare me Jeffrey Epstein-in



Miliarderi amerikan Leon Black ka refuzuar të paraqitet në një seancë dëgjimore nën betim përpara Kongresit amerikan, duke u përballur tashmë me rrezikun e një procedure të mundshme për shpërfillje të kongresit.

Bashkëthemeluesi i gjigantit të investimeve Apollo Global Management është përfshirë në hetimet që lidhen me marrëdhëniet e tij financiare me Jeffrey Epstein. Kongresi po kërkon të zbardhë më tej natyrën e këtyre marrëdhënieve dhe veçanërisht marrëveshjet financiare mes tyre.

Gjatë një seance të mëparshme në qershor, Black pranoi se i kishte paguar Epstein 158 milionë dollarë për këshillim lidhur me taksat dhe pasurinë. Megjithatë, ai ka mohuar se kishte dijeni për aktivitetet kriminale të Epstein-it dhe ka mohuar çdo akuzë për sulme seksuale ndaj grave.

Seanca e mëparshme ishte ndërprerë pasi Black refuzoi t'u përgjigjej pyetjeve lidhur me marrëveshjet e konfidencialitetit që kishte lidhur me gra.

Pas kësaj, ligjvënësit e thirrën sërish për të dëshmuar nën betim, ndërsa i kërkuar edhe të dorëzonte dokumente që lidhen me këto marrëveshje. Por miliarderi nuk iu bind thirrjes.

Në vend të paraqitjes përpara kongresit, Black iu drejtua gjykatës federale për të kundërshtuar kërkesat e ligjvënësve. Avokatja e tij, Susan Estrich, argumentoi se komiteti po kërkon informacione që tejkalojnë mandatin e tij dhe akuzoi ligjvënësit se synojnë të dëmtojnë reputacionin e klientit të saj.

Ndërkohë, më shumë se një duzinë grash që kanë deklaruar se janë sulmuar seksualisht nga Jeffrey Epstein i kanë bërë thirrje Black që të zbatojë kërkesat e kongresit. Sipas tyre, marrëveshjet e konfidencialitetit të nënshkruara prej tij mund të ndihmojnë në zbardhjen e marrëdhënieve të tyre me Epstein-in dhe persona të tjerë të rrethit të financierit.

Kryetari republikan i komitetit, James Comer, e kritikoi ashpër vendimin e Black-ut, duke deklaruar se miliarderi po zgjedh të fshihet pas një beteje ligjore në vend që t'u përgjigjet pyetjeve të kongresit. Ai tha se komiteti do të shqyrtojë hapat e mëtejshëm.

Edhe kongresmeni demokrat Robert Garcia bëri thirrje për nisjen e procedurave për shpërfillje të kongresit, duke theksuar se Black ka injoruar tashmë dy thirrje të këtij organi.


Mos i humb

- [Një veturë e FSK-së përfshihet në një aksident trafiku në kryeqytet \(Foto\)](#)






- [“Ndryshoi jetën time”, ushtari i KFOR-it kujton momentin e hyrjes në Kosovë 25 vjet më parë](#)



- [“I ke 30 minuta... Koha po kalon, kanë mbetur dhe 28 minuta”/ Kush është komandanti gjerman, që i dëboi nga Prizreni ushtarët serbë?](#)



- [Shoferi i duhur gjobitet 2 herë brenda pak minutash, për tejkalim shpejtësie](#)

- [Hajdari: Roli i Avokatit të Popullit të mos involvohet në procedura gjyqësore](#)

- [AKB: Rreth 40 për qind të bizneseve s'e përdorin arkën fiskale në mënyrën e duhur](#)

- [Aksident i rëndë në autostradën "Ibrahim Rugova", të lënduarve po iu ofrohet ndihma mjekësore](#)



Të fundit nga Showbiz

- [23:30 / E Diele, 06 Shtator](#)
[Motra e Laurent Krasniqit thyen heshtjen pas humbjes së rëndë](#)
- [23:00 / E Diele, 06 Shtator](#)
[Eva në deti, 'nxehet' interneti](#)
- [22:30 / E Diele, 06 Shtator](#)
[Bad Bunny vazhdon të thyejë rekorde, 7 çmime Emmy për shfaqjen e Super Bowl](#)
- [22:00 / E Diele, 06 Shtator](#)
[Pamje ekskluzive, martohet vajza e Bedri Hamzës, kryetari i PDK-së vallëzon me çiftin](#)
- [21:30 / E Diele, 06 Shtator](#)
[Pse bën paraqitje publike nu*do? Bianca trazon rrjetin](#)
- [21:00 / E Diele, 06 Shtator](#)
[Doarsa, Hykmetja apo Jehona? Ja cila deputete e LDK-së ka më shumë ndjekës në Facebook](#)

TEL Redaksia: +383 (0) 48 36 36 39 | Marketing: +383 (0) 49 686 666 **EMAIL** info@indeksonline.net marketing@indeksonline.net [Indeksonline.net](https://www.indeksonline.net)



Portali Indeksonline u themelua nga një grup gazetarësh kosovarë në vitin 2010. Përball sfidave të gazetarisë bashkëkohore, të motivuar nga nevoja për lajme të shpejta dhe origjinale, në Kosovë, ndër shqiptarë dhe për shqiptarët – Indeksonline nuk ishte veçse një kërkesë e kohës.

Materialet dhe informacionet mund të kopjohen, të shtypen dhe të përdoren por vetëm pas referimit të qartë të burimit të Portalit Indeksonline, në përputhje me kushtet e përdorimit.!!

© 2010 - 2026 Portali Indeksonline. Të gjitha të drejtat janë të rezervuara.

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.